

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“TEA 007” SHPK

FORMIMI

Sot me datë 09.12.2024, u hartua akti i themelimit, bazuar në kërkesat e ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 “Për shoqëritë Tregtare” formohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e emertuar “TEA 007” SHPK e ortakëve themelues shoqëria “JUGUFARM” sh.p.k. me nr NIPT: L123030321, me adrese në Tirane Vaqarr Fortuzaj, Rruga Vaqarr-Fortuzaj, Ndertese te Zona Kadastrale Nr.3963, Nr.Pasurie 31/14, përfaqësuar nga administratori z.Gjergji Papadhami me nr ID H80515237S.

FORMA JURIDIKE

Forma juridike e shoqërisë është “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar”.

KOHEZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë është me afat të pacaktuar.

SELIA

Selia e shoqërisë “TEA 007” sh.p.k është: Tirane, Laprake, Rruga Dritan Hoxha, pallati i Procredit Bank, Hyrja 3, Ap 2, kati 3.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë ekonomike të shoqërisë “TEA 007” shpk është:

Ndermjetesim per transaksione me pasuri te paluajtshme. Ndertim,Shit-Blerje e pasurive te paluajtshme. Dhenie me qira. Vleresim te pasurive te paluajtshme.Te tjera dhe te ngjashme. Shitje, blerje, dhenie dhe me qira te pasurive te paluajtshme.

Të gjitha veprimtaritë e përshkruara me sipër mund të kryhen qoftë për llogari të shoqërisë vete ashtu dhe për llogari të të tretëve.



Kapitali i shoqërisë.

Kapitali themelor i shoqërisë është 100 000 (LEK) .Të ndara në 1 kuote.

Kontributi i ortakëve.

Ortaku i vetem i shoqërisë është “JUGUFARM” sh.p.k, me nr NIPT: L12303032I, me adrese në Tirane Vaqarr Fortuzaj, Rruga Vaqarr-Fortuzaj, Ndertese te Zona Kadastrale Nr.3963, Nr.Pasurie 31/14, përfaqësuar nga administratori z.Gjergji Papadhani me nr ID H80515237S. me 100 % ose 100 000 leke.

Organet drejtuese

Asambleja e ortakëve është organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë. Cdo ortak ka të drejte të marrë pjesë në asamble dhe të bëjë prezent opinionin e tij. Numri i votave të çdo ortaku është në raport me pjesen e tij të kapitalit në kapitalin themelor të shoqërisë.

Shoqëria tregtare “TEA 007” SHPK do drejtohet nga administratori z.Gjergji Papadhani.

Në mardhënie me të tretet shoqëria përfaqësohet nga administratori. Në emer të shoqërisë firmos administratori i cili i bashkangjitet emertimin tregtar të shoqërisë, emrin, mbiemrin dhe funksionin e tij. Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët themelues.

ORTAKET THEMELUES

JUGUFARM SHPK

ORTAKU

Gjergji Papadhani

Gjergji Papadhani

